



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR LEZHE

Nr.186 akti
Dt.19.5.2015 regj

Vendimi nr.186
Dt.12.6.2015

Vendim
“Ne emer te Republikes”

Gjykata e rrethit gjyqesor Lezhe e perbere prej:

Gjyqtar Ilir Perdeda

ne pranine e sekretares gjyqësore Jolanda Gjeçi, ne Lezhe, sot me dt.12 qershor 2015, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer te mbyllura çështjen penale nr.186 akti që i perket:

Kerkuese: Prokuroria e rrethit gjyqesor Lezhe e perfaqesuar nga prokurori Erjon Shehaj.

Me objekt: Vendosje sekuestro preventive.

Baza ligjore: Neni 274 i Kodit te Proçedures Penale.

Ne perfundim te gjykimit prokurori kerkoi pranimin e kerkeses.
Gjykata si degjoi prokurorin dhe shqyrtoi materialin provues,

Veren se:

Kerkesa e Prokurorise se rrethit gjyqesor Lezhe eshte e bazuar ne ligj e prova e duhet pranuar.

Rezulton se mbi bazen e materialit proçedural penal te referuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Lezhe ne ngarkim te dyshuarit A L (dt.18.4.1981), Prokuroria e rrethit gjyqesor Lezhe (ne tekstin vijues: Prokuroria) me daten 9.10.2013 ka regjistruar proçedimin penal nr.615, ne lidhje me vepren penale te parashikuar ne nenin 287 te Kodit Penal, pa autor te dyshuar (referuar informacionit policor dhe urdherit te regjistrimit).

Me tej, ne rrjedhen e hetimeve, e konkretisht me daten 15.5.2015, Prokuroria ka regjistruar emerine e shtetasit A L si i dyshuar te kete lidhje me faktet qe i perkasin proçedimit te mesiperm penal (referuar urdherit perkates).

Ne vijim, referuar akteve te autoriteteve policore italiane, ka rezultuar se i dyshuari A L eshte denuar nga Gjykata e Milanos ne Itali me 7 vite burgim per vepren penale te trafikimit te lendeve narkotike. Po ashtu, ka rezultuar se i dyshuari A L eshte aksioner ne disa shoqeri tregtare Shqiptare, e konkretisht “J ” shpk (33.3%), “M S G ” shpk (40%) dhe “D K ” shpk (50%) (referuar akteve perkatese te leshuara nga QKR, DPT etj).

Ne vazhdim, nga aktet shkresore te paraqitura nga Prokuroria rezulton se i dyshuari A L , ne kuader te shoqerive te mesiperme ka bere transaksione bankare ne vlera te medha, ka marre kontrata sipermarrije per ndertime objektesh banimi, ka bere shitje te disa apartamenteve te banimit, ka regjistruar pasuri te paluajteshme ne emer te tij dhe pjestareve te familjes se tij.

Ka rezultuar se i dyshuari A L ka ndryshuar gjeneralitet nga A L ne A L dhe sipas Prokurorise ka aresye per te besuar se kete veprim e ka kryer per te mos u identifikuar nga autoritetet Italiane te ndjekjes penale.



711

Nga zyra e policise Italiane ne Shqiperi (Interforce) eshte relatuar se, ndaj te dyshuarit Astrid Limani ne vitin 2007 eshte leshuar masa e sigurise "Arrest ne burg" nga Gjykata e Milanos nen dyshimin e kryerjes se vepres penale te trafikimit te lendeve narkotike. Po ashtu, nga autoritetet Italiane te Drejtesise, i dyshuari A L eshte pergjuar duke kryer komunikime telefonike me te aferm dhe bashkepunetore te tij, ne kohen kur dyshohet te kete kryer veprimtarine kriminale (viti 2004) dhe qendronte ne Prage, duke perdorur tre numera telefoni. Per me teper, faktet kriminale qe kane te bejne me trafikimin e lendeve narkotike nga i dyshuari A L i ka deshmuar perpara autoriteteve Italiane te drejtesise "korieri" i tij, i cili ka pershkruar ne detaje dhe hotelin ne pronesi te dyshuarit A L qe ndodhet 3 km larg qytetit Shengjin.

Duke qene se i dyshuari A L kerkohej nderkombetarisht si i denuar ne mungese nga autoritetet Italiane te drejtesise per kryerjen e vepres penale te trafikimit te lendeve narkotike, duke qene se ne Shqiperi zoteronte aksione, prona te paluajteshme ne vlera te medha dhe shoqerite tregtare ne te cilat ai ishte aksioner kishin kryer transkacione monetare ne vlera te medha, me te drejte Prokuroria e rrethit gjyqesor Lezhe dyshon se nepermjet ketyre veprimtarive tregtare te zhvilluara ne Shqiperi i dyshuari A L po kryen pastrimin e parave te fituara nga aktiviteti kriminal per te cilin eshte denuar nga autoritetet Italiane te drejtesise, duke bere transferimin e tyre ne Shqiperi dhe investimin ne aktivitete tregtare, ndertimi, sipermarrje, hoteleri, shitje pasurise se paluajteshme, etj, ne kuptim te percaktimeve te nenit 287 te Kodit Penal, ne te cilin percaktohet:

Pastrimi i produkteve te veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

- dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Konkretisht, i gjitha materiali provues i siguruar nga sistemi bankar në Shqipëri, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, QKR, etj, ngre dyshime serioze se investimet dhe transaksionet financiare të kryera nga i dyshuari A L , apo shoqëritë ku ai është aksioner, nuk justifikohen me të ardhurat e evidentuara.

Per me teper, nepermjet bashkepunimit me ZVRPP Lezhe dhe ZQRPP Tirane ka rezultuar se ne pronesi apo bashkepronesi te dyshuarit A L i figurojne te regjistruara disa pasuri te paluajteshme, e konkretisht (te cilat jane objekt i kerkeses) pasuria nr.777 e ndodhur ne qytetin Shengjin (hotel-bar-restorant) me sipërfaqe 1940 m2, pasuria nr.682 e ndodhur ne qytetin Shengjin (11 kate banim+1 kat papafingo+1 kat bodrum), pasuria nr.683 (parkim nentokesor), pasuria nr.684 (njësi tregtimi), pasurite nr.685-750 (apartamente banimi), pasuria nr.1046 (8 kat banimi+1 kat papafingo+1 kat bodrum dhe parkim), pasuria nr.1047 (parkim nentokesor), pasuria nr.1048 (njësi tregtimi), pasurite nr.1049-1114 (apartamente banimi), pasuria nr.945 (godine 2 kat njësi tregimi+9 ka banimi+1 kat pub panoramic+1 kat bodrum), pasuria nr.946 (garazhe parkimi), pasurite nr.947, 948 dhe 1039 (njësi tregtimi) dhe pasurite nr.949-1038 (apartamente banimi).

Nga krahasimi i llojit te pasurive ne pronesi ose bashkepronesi te dyshuarit Astrid Limani, sasise, natyres, vendodhjes dhe destinacionit te tyre, vertetohet vlefte e madhe e tyre, e cila, krahasuar me te dhenat bankare, te tatimeve dhe QKR, nuk mbulohet (justifikohet) me ato te siguruar ne menyre te ligjeshme nga i dyshuari A L , personalisht, kredite apo nga te ardhurat si aksioner ne shoqëritë ku ben pjese. Per rrjedhoje, Gjykata vlereson se vlefte e madhe e pasurive te mesiperme te identifikuar ne emer te dyshuarit A L ka aresye per te dyshuar se eshte siguruar nga aktiviteti i tij kriminal per te cilin eshte denuar nga autoritetet Italiane te drejtesise, kjo vlefte eshte transferuar ne Shqipëri dhe investuar ne krijimin e shoqërive, ne ndertim dhe shitjen e apartamenteve etj.

Sa siper, Gjykata e vlereson se drejte dyshimin e Prokurorise ne lidhje me ate se vlefte e pasurive te fituara ne Shqipëri nga i dyshuari A L eshte bere nepermjet pastrimit te parave dhe se keto veprime te tij mund te kene lidhje me nenin 287 te Kodit Penal.

Per me teper, Gjykata vlereson se perballja me procedimin penal, me llojin e masen e rende te denimit qe parashikon neni 287 i Kodit Penal, jane aresye per te dyshuar se A L mund te tjetërsoje pasurite e mesiperme tek te tretet, duke shtuar pasojat e vepres penale qe dyshohet te kete kryer dhe zhdukur keto pasuri si prova te vepres penale te kryer prej tij dhe pasojave te shkaktuara.


Duke konkluduar, Gjykata vlereson se kerkesa e Prokurorise eshte e bazuar ne nenin 274 te Kodit te Proçedures Penale, ne kuptimin qe duhet vendosur sekuestro preventive mbi pasurite e mesiperme te kerkuara prej Prokurorise, te cilat jane identifikuar ne pronesi ose bashkepronesi te dyshuarit A L , duke u urdheruar Zyrene vendore te regjistrimit te pasurive te paluajteshme Lezhe qe te mos kryeje asnje transferim te te drejtave te pronesise mbi keto pasuri, apo t'i ngarkoje me barre ipotekore, pa lejen e Gjykates.

Per keto aresye:

Gjykata bazuar ne neni 247 te KPP,

Vendosi:

- Pranimin e kerkeses se Prokurorise se rrethit gjyqesor Lezhe.
- Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e meposhtme:
 - Pasuria me nr.777, e ndodhur në zonën kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë Hotel-Bar-Restorant me sipërfaqe totale 1940 m2, e cila përfshin:



- Një godinë 5 katëshe, të ndodhur në qytetin e Shëngjinit, të quajtur “J ” me shërbime Hotel-Bar-Restorant, ku përfshihen kati përdhe me sipërfaqe 416.38 m², kati I+II me sipërfaqe 460.31 m², kati IV me sipërfaqe 416.38 m², kati V me sipërfaqe 186.62 m².
- Pasuria me nr.682, e ndodhur në zonën kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë godinë 11 kate banim + 1 kat papafingo + 1 kat bodrum (parkim), në emër të shoqërisë “K I ” sh.p.k, e cila përfshin:
 - Një godinë 11 kate banim + 1 kat papafingo + 1 kat bodrum, të ndodhur në qytetin e Shëngjinit, ku përfshihen:
- Pasuria me nr.683, zk.3126, kati nëntokë që shërben si parkim me sipërfaqe 391 m²;
- Pasuria me nr.684, zk.3126, kati përdhe që shërben si njësi tregëtimi, me sipërfaqe 391 m²;
- Pasuritë me nr. 685-750, zk.3126, kati I-XI që shërbejnë si apartamente banimi.
- Pasuria me nr.1046, e ndodhur në zonën kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë godinë 8 kate banim + 1 kat papafingo + 1 kat bodrum (parkim), e cila përfshin: Një godinë 8 kate banim + 1 kat papafingo + 1 kat bodrum (parkim), ku përfshihen:
 - Pasuria me nr.1047, zk.3126, kati nëntokë që shërben si parkim me sipërfaqe 391 m²;
 - Pasuria me nr.1048, zk.3126, kati përdhe që shërben si njësi tregëtimi, me sipërfaqe 575 m²;
 - Pasuritë me nr.1049-1114, zk.3126, kati I-XI që shërbejnë si apartamente banimi.
- Pasuria me nr.945, e ndodhur në zonën kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë: godinë me 2 kate njësi tregëtare, 9 kate banimi + 1 kat Pub Panoramik + 1 kat bodrum (parkim), e cila përfshin:
 - Një godinë 8 kate banim + 1 kat papafingo + 1 kat bodrum (parkim), ku përfshihen:
 - Pasuria me nr.946, zk.3126, kati nëntokë që shërben si garazhe parkimi, me sipërfaqe 865 m²;
 - Pasuritë me nr.947, 948 dhe 1039, zk.3126, që shërbejnë si njësi tregëtimi;
 - Pasuritë me nr.949-1038, zk.3126, kati II-XI që shërbejnë si apartamente banimi;

Urdhërohet Zyra vendore e regjistrimit të Pasurive të Paluajteshme Lezhe të mos kryejë asnjë veprim tjetërsimi mbi pasuritë e mesiperme.

Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet shërbimi i policisë gjyqësore, Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajteshme Lezhe dhe Prokuroria.

Kunder vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Shkoder brenda 10 diteve nga e nesërmja e shpalljes ose e marrjes dijeni prej personave të interesuar.

U shpall në Lezhe, sot me dt.12 qershor 2015

Sekretarë

Jolanda Gjeçi

Gjyqtar

Ilir Perdeda

Shenim: Gjykata e Apelit Shkoder me vendimin nr. 198, date 31.07.2015 ka vendosur:
Miratimin e vendimit nr.186, date 12.06.2015, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Lezhe.

Ela Nikaj

Kancelare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Lezhe



Konceptoi: K/S
Ilirian Jaku